



UNMIK



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISESE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA
QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT

MINISTRY OF EDUCATION

MINISTARSTVO ZA

SHKENCËS DHE
TEKNOLOGJISË

SCIENCE & TECHNOLOGY

OBRAZOVANJE
NAUKU I TEKNOLOGIJU

Zyra e Sekretarit të Përhershëm

Office of the Permanent Sekretara

Kancelarija Stalnog Sekretara

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Aplikimi i Procedurave të Projektit për Përmirësimin e Pjesëmarrjes në Arsim (PPPA) të financuar nga Banka Botërore

NUMËR: MASHT [I] 23/2005

DATË: 20.06.2005

Në bazë të nenit 5.4 pika (c) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 Mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetqeverisjes në Kosovë, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim Administrativ:

Neni 1

Qëllimi:

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është që të përmbushen / aplikohen rregullat dhe obligimet e parapara duke u bazuar në Marrëveshjen e nënshkruar në mes Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Bankës Botërore (IDA) dhe Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK).

Neni 2

Procedurat e prokurimit

2.1. Çdo projekt i financuar nga fondet e Bankës Botërore do të implementohet në bazë të procedurave të prokurimit të Bankës Botërore, të parapara në Doracakun e Prokurimit të Projektit për Përmirësimin e Pjesëmarrjes në Arsim (PPPA).

- 2.2.** Pavarësisht nga shuma e kontributit të komunitetit dhe të komunës si shtesë e donacionit të Bankës Botërore rregullat e prokurimit do të jenë po të njëjtat të parapara në Doracakun e Prokurimit, edhe nëse shuma e komunitetit apo komunës tejkalon grantin e dhënë shkollës.
- 2.3.** Drejtorët Komunal të Arsimit, Zyrtarët e Prokurimit si dhe Zyrtarët Financiarë e personat të tjerë përgjegjës për implementimin dhe zbatimin e projektit në të gjitha komunat obligohen t’i përmbahen rregullave të lartpërmendura për grantet e dhëna nga Projekti i Bankës Botërore.
- 2.4.** Për të gjitha projektet e dhëna nga Projekti për Përmirësimin e Pjesëmarrjes në Arsim të financuar nga Banka Botërore, Implementuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, do të aplikohen procedurat e Bankës Botërore dhe jo ato vendore.
- 2.5.** Drejtorët Komunal të Arsimit përveç autoritetit të cilin e gëzojnë me pozitën e punës në të gjitha komunat, DKA-të po ashtu janë të autorizuar për nënshkrimin e Marrëveshjeve për Grante Shkollore si të tillë ata do të udhëzojnë Kryeshefat, Zyrtarët e Prokurimit dhe Zyrtarët Financiarë për aplikimin e procedurave të lartpërmendura.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga Sekretari i Përhershëm.

Isuf Zeneli, Sekretar i Përhershëm